L I G J
Nr.9007, datë 13.2.2003

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES SË HUASË NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM "PROJEKTI II URGJENT PËR REHABILITIMIN E RRUGËVE""

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja e huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim "Projekti II urgjent për rehabilitimin e rrugëve"".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3721, datë 28.2.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu.

MARRËVESHJA
E HUASË (PROJEKTI II URGJENT PËR REHABILITIMIN E RRUGËVE)
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EUROPIANE
PËR RINDËRTIM E ZHVILLIM

Marrëveshja datë 16 dhjetor 2002 ndërmjet Republikës së Shqipërisë ("Huamarrësit") dhe Bankës Europiane për Rindërtim e Zhvillim ("Bankës")

Parathënie

Duke qenë se, Banka është krijuar për të financuar projekte specifike për të ndihmuar tranzicionin drejt ekonomive të hapura e të orientuara nga tregu dhe për të nxitur nismat dhe sipërmarrjet private në vendet e Europës Qendrore e Lindore, të cilat janë angazhuar për zbatimin e parimeve të demokracisë shumëpartiake, pluralizmit dhe ekonomisë së tregut;

duke qenë se, Banka synon të zbatojë Projektin siç përshkruhet në planin 1, i cili është hartuar për të ndihmuar Huamarrësin për rehabilitimin e një pjese prej 30.5 km të rrugës së Korridorit Lindje – Perëndim ndërmjet Elbasanit dhe Librazhdit;

duke qenë se, Huamarrësi, me mbështetjen e Bankës, ka siguruar financimin e një fondi dhuratë nga nisma e Europës Qendrore, në shumën prej një milion e shtatëqind mijë Euro (1.700.000 euro) dhe financimin e një fondi dhuratë nga Ministria e Punëve të Jashtme të Italisë, nëpërmjet Drejtorisë së saj të Përgjithshme për Zhvillim e Bashkëpunim, në shumën prej tre milion e tetëqind mijë euro (3.800.000 euro) për zbatimin e pjesës A-2 të Projektit;

duke qenë se, Huamarrësi ka rënë dakord të përdorë dy milion euro (2.000.000 euro) nga fondet e veta për zbatimin e pjesës A-1 të Projektit;

duke qenë se, Banka ka pranuar që, ndërmjet të tjerave, mbi bazën e asaj që deklarohet më lart, t'i ofrojë një hua Huamarrësit në shumën prej shtatëmbëdhjetë milion euro (17.000.000 euro)

sipas afateve dhe kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje, në këtë shumë do të përfshihet fondi prej një milion euro (1.000.000 euro) për të financuar kostot e shpështjellimit, në lidhje me shpështjellimin e huasë origjinale (të përcaktuar më poshtë); dhe një milion euro (1.000.000 euro) për të financuar pjesën B të projektit;

duke qenë se, në lidhje me huanë origjinale (të përcaktuar më poshtë) deri tani nuk është bërë asnjë livrim;

si rrjedhim, Palët me anë të kësaj kontrate bien në marrëveshje si vijon:

Neni 1

Termat dhe kushtet standarde; përkufizime

1.01 Përfshirja e termave dhe kushteve standarde

Të gjitha dispozitat e termave dhe kushteve standarde të shkurtit 1999 përfshihen dhe zbatohen në këtë Marrëveshje me të njëjtën fuqi dhe efekt sikur të ishin parashtruar krejtësisht brenda kësaj Marrëveshjeje duke qenë sidoqoftë, subjekt i modifikimeve të mëposhtme (dispozita të tilla, të modifikuara kështu, këtu e më poshtë do të quhen "termat dhe kushtet standarde").

Përkufizimi i "ditës së punës" në paragrafin 2.02 të termave dhe të kushteve standarde, të shkurtit 1999, të Bankës do të modifikohet dhe lexohet në funksion të kësaj Marrëveshjeje, si vijon:

"Dita e punës" do të thotë një ditë në të cilën sistemi automatik transeuropian për transfertat e shpejta në kohë reale (Sistemi Target) është i hapur.

1.02 Përkufizimet

Termat e përkufizuara në parathënie, të përdorura në këtë Marrëveshje (duke përfshirë parathënien dhe planet), përveç rasteve kur deklarohet ndryshe, kanë kuptimet përkatëse që u janë dhënë; termat e përkufizuara në termat dhe kushtet standarde kanë kuptimet përkatëse që u janë dhënë dhe termat në vijim kanë kuptim si vijon:

"Fondet e NEQ"	do të thotë: një fond dhuratë në shumën jo më pak se një milion e shtatëqind mijë euro (1.700.000 euro) që do të sigurohen nga Huamarrësi nga nisma e Europës Qendrore.
"Projekti i Korridorit Lindje-Perëndim"	do të thotë: programi i riparimeve, rehabilitimit dhe përmirësimit të sigurisë, duke përfshirë Projektin, i cili zbatohet nga Huamarrësi për të riparuar dhe rinovuar segmente të rrugës, e cila është pjesë e "Korridorit Lindje –Perëndim" (një autostradë 71.5 km e gjatë në Republikën e Shqipërisë, e cila lidh Durrësin me Varnën).
"Vit fiskal"	do të thotë: viti fiskal i Huadhënësit që fillon në 1 janar të çdo viti.
"Financim dhuratë"	do të thotë: fondet e NEQ-it, fondet e ICD-së dhe çdo fond tjetër zëvendësues apo koncesion i miratuar nga Banka.
"Fondet e bashkëpunimit italian"	do të thotë: fondet dhuratë në shumën jo më pak se tre milion e tetëqind mijë euro (3.800.000 euro) për t'iu siguruar Huamarrësit nga Ministria Italiane e Punëve të Jashtme nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme për Zhvillim e Bashkëpunim.
"IDA"	do të thotë: Shoqata për Zhvillim Ndërkombëtar, anëtare në grupin e Bankës Botërore.
"Projekti i transportit i IDA-s"	do të thotë: çdo projekt i financuar nga IDA për ndërtimin dhe rehabilitimin e rrjetit të transportit, duke përfshirë rrugët, hekurudhat dhe portet, në territorin e Huamarrësit.
"Marrëveshja e kredisë së IDA-s"	do të thotë: Marrëveshja e kredisë ndërmjet Huamarrësit dhe IDA-s, datë 17 korrik 1996, e cila parashikon, ndërmjet të tjerave, kredi në shuma të përafërta prej njëzet e pesë milion dollarë amerikanë (25.000.000 USD) për të financuar Projektin e Korridorit Lindje–Perëndim jashtë kuadrit të Projektit.
"FMN"	do të thotë: Fondi Monetar Ndërkombëtar.
"Të drejtat e tokës"	do të thotë: të drejtat e përdorimit të tokës të cilat janë të nevojshme për zbatimin e Projektit, siç përcaktohet nga konsulentët e Projektit.

"Huaja origjinale"	do të thotë: një hua në shumën prej dhjetë milion euro (10.000.000 euro) për t'iu ofruar Huamarrësit nga ana e Bankës sipas Marrëveshjes së Huasë midis Bankës dhe Huamarrësit, datë 8 dhjetor 1999.
"PIU"	do të thotë: Njësia e Zbatimit të Projektit, e cila krijohet nga Huamarrësi për të administruar, monitoruar dhe vlerësuar të gjitha aspektet e zbatimit të Projektit të Korridorit Lindje –Perëndim, duke përfshirë prokurimin e mallrave, punimeve dhe shërbimeve për Projektin e Korridorit Lindje-Perëndim.
"PRGF"	do të thotë: Programi i strategjisë 3-vjeçare (2002-2005), për reduktimin e varfërisë, aprovuar nga FMN-ja, në qershor të vitit 2002.
"Konsulentët e Projektit"	do të thotë: konsulentët të cilët janë angazhuar tashmë nga ana e Huamarrësit sipas paragrafëve 3.03 (a) dhe 3.05.
"Faqja e referimit"	do të thotë: paraqitja e përqindjeve të ofruara nga bankat në zonën Euro për monedhën e huasë, e caktuar si faqja 248 në Telerate (ose çdo faqe tjetër që mund të zëvendësojë faqen 248 në Telerate në funksion të shfaqjes së përqindjeve të ofruara nga bankat në zonën Euro për depozitat në monedhën e huasë).

1.03 Interpretimi

Në këtë Marrëveshje, referimi ndaj një neni, paragrafi apo plani të përcaktuar, përveç rasteve kur deklarohet ndryshe në këtë Marrëveshje, do të nënkuptohet si referim ndaj nenit, paragrafit ose planit të përcaktuar të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 2
Kushtet kryesore të huasë

2.01 Shuma dhe monedha e huasë

Banka bie dakord t'i japë Huamarrësit një hua në shumën shtatëmbëdhjetë milion euro (17.000.000 euro) sipas afateve dhe kushteve të përcaktuara e të marra për bazë në këtë Marrëveshje.

2.02 Kushte të tjera financiare të huasë

a) Shuma minimale për t'u tërhequr do të jetë pesëqind mijë euro (500.000 euro).

b) Shuma minimale e parapagesës do të jetë një milin euro (1.000.000 euro).

c) Shuma minimale e anulimit do të jetë një milion euro (1.000.000 euro).

d) Datat e pagesës së interesit do të jenë 18 qershori dhe 18 dhjetori i çdo viti.

e) Huamarrësi do të shlyejë shumën e huasë në datat dhe shumat e mëposhtme:

Data e shlyerjes së huasë	Shumat e huasë që duhen paguar
18 qershor 2006	708.333,00 euro
18 dhjetor 2006	708.333,00 euro
18 qershor 2007	708.333,00 euro
18 dhjetor 2007	708.333,00 euro
18 qershor 2008	708.333,00 euro
18 dhjetor 2008	708.333,00 euro
18 qershor 2009	708.333,00 euro
18 dhjetor 2009	708.333,00 euro
18 qershor 2010	708.333,00 euro
18 dhjetor 2010	708.333,00 euro
18 qershor 2011	708.333,00 euro
18 dhjetor 2011	708.333,00 euro
18 qershor 2012	708.333,00 euro

18 dhjetor 2012	708.333,00 euro
18 qershor 2013	708.333,00 euro
18 dhjetor 2013	708.333,00 euro
18 qershor 2014	708.333,00 euro
18 dhjetor 2014	708.333,00 euro
18 qershor 2015	708.333,00 euro
18 dhjetor 2015	708.333,00 euro
18 qershor 2016	708.333,00 euro
18 dhjetor 2016	708.333,00 euro
18 qershor 2017	708.333,00 euro
18 dhjetor 2017	708.341,00 euro
Totali	17.000.000,00 euro

f) Data e fundit e disponueshmërisë do të jetë 31 dhjetori 2006.

g) Përqindja e tarifës së angazhimit do të jetë një gjysëm përqind (0.5%) në vit.

h) Huaja është subjekt ndaj një përqindjeje të ndryshueshme interesi. Në funksion të paragrafit 3.04 (b) të termave dhe kushteve standarde, përqindja përkatëse e interesit në treg do të jetë përqindja e ofruar në vit për depozitat në monedhën e huasë, e cila shfaqet në faqen e referimit në orën 11.00, sipas orës së Brukselit, të datës përkatëse të përcaktimit të normës së interesit për periudhën e cila është më pranë kohëzgjatjes së periudhës përkatëse të interesit (ose në qoftë se dy periudha janë njëlloj afër kohëzgjatjes së periudhës përkatëse të interesit, mesatarja e dy përqindjeve përkatëse do të merret) me kusht që:

1. Në qoftë se, për ndonjë arsye, përqindja përkatëse e interesit në treg nuk mund të përcaktohet në një kohë të tillë, duke marrë për bazë faqen e referimit, atëherë përqindja përkatëse e interesit në treg do të jetë përqindja, të cilën banka e përcakton si mesatare aritmetike (rrumbullakosur me rritje, nëse është e nevojshme, në të 1/16-tën për qind më të afërt) të përqindjes së ofruar në vit për depozitat në monedhën e huasë dhe me një shumë të krahasueshme me pjesën e huasë, e cila është planifikuar për të qenë e papaguar gjatë periudhës përkatëse të interesit për një periudhë e cila është e barabartë me një periudhë të tillë interesi, siç i këshillohet Bankës nga tri banka të tjera kryesore, që veprojnë në tregun ndërbankar të zonës së Euros dhe që zgjidhen nga Banka.

2. Në qoftë se Banka vendos se depozitat në monedhën e huasë nuk do të ofrohen në tregun ndërbankar të zonës së Euros në shuma ose për periudha të tilla, përqindja përkatëse e interesit në treg do të llogaritet si kostoja e bankës (e shprehur si përqindje për vit) për financimin e pjesës së huasë, që është planifikuar të jetë e papaguar gjatë periudhës përkatëse të interesit nga cilido burim që ajo zgjedh.

2.03 Tërheqjet e shumave

a) Nga shuma e disponueshme mund të bëhen herë pas here tërheqje sipas dispozitave të paragrafit 2 për të financuar: (1) shpenzimet e bëra (ose në qoftë se pranon Banka, shpenzimet që do të bëhen), lidhur me koston e arsyeshme të mallrave, punimeve e shërbimeve që kërkohen për Projektin; (2) komisionin e huasë.

b) Me anë të kësaj Marrëveshjeje, Huamarrësi e autorizon Bankën të tërheqë nga shuma e disponueshme shumën e barabartë me komisionin e huasë dhe t'ia paguajë komisionin vetes për llogari të Huamarrësit.

c) Me anë të kësaj Marrëveshjeje, Huamarrësi e autorizon Bankën të tërheqë nga shuma e disponueshme dhe t'i paguajë vetes për llogari të Huamarrësit një shumë prej një milion euro (1.000.000 euro) në lidhje me kostot e shpështjellimit të huasë origjinale.

2.04 . Përfaqësuesi i autorizuar për tërheqjen e fondeve

Ministri i Financave të Huamarrësit caktohet si përfaqësues i autorizuar i Huamarrësit për marrjen e çdo mase që kërkohet ose lejohet të merret, sipas dispozitave të paragrafit 2.03 (a) të kësaj Marrëveshjeje dhe sipas dispozitave të paragrafit 3.01 dhe 3.02 të termave dhe kushteve standarde.

Neni 3
Zbatimi i Projektit

3.01 Klauzola të tjera mbështetëse të Projektit

Përveç masave të përgjithshme, të përcaktuara në nenet IV dhe V të termave dhe kushteve standarde, po qe se Banka nuk bie dakord ndryshe, Huamarrësi:

a) do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar fonde të mjaftueshme për përfundimin e Projektit dhe do t'i verë fonde të tilla në dispozicion të Projektit si kontribute të paripagueshme për të financuar kostot e Projektit;

b) do të veprojë në përputhje me të gjitha detyrimet e saj nën/ose në lidhje me: (i) programin e strategjisë për reduktimin e varfërisë (PRGF) dhe të gjitha marrëveshjet e tjera me FMN-në; (ii) Marrëveshjen e kredisë së IDA-s; (iii) të gjitha kontratat e punimeve civile që lidhen me Projektin; (iv) financimin e grantit; (v) të gjitha projektet e transportit të IDA.

3.02 Njësia e Zbatimit të Projektit

Huamarrësi do të shfrytëzojë njësinë e zbatimit të Projektit (PIU) për të koordinuar, administruar, monitoruar dhe vlerësuar të gjitha aspektet e zbatimit të Projektit, duke përfshirë prokurimin e mallrave, punimeve dhe shërbimeve për Projektin. Po qe se nuk arrihet marrëveshje ndryshe me Bankën, Huamarrësi do të mbajë një njësi të zbatimit të Projektit gjatë të gjithë kohës gjatë zbatimit të projektit dhe do ta verë atë në veprim, me burime të mjaftueshme dhe me personel të kualifikuar siç duhet, duke përfshirë në ekipin e PIU-t së paku një konsulent të huaj, sipas kushteve të pranueshme për Bankën. Pa kufizuar sa më lart, detyrimet e Huamarrësit nën këtë paragraf 3.02 nuk do të ndikohen nga ndonjë përfundim apo ndryshim i Marrëveshjes së kredisë së IDA-s.

3.03 Prokurimi

Në funksion të paragrafit 4.03 të termave dhe kushteve standarde dhe, po qe se Banka nuk bie dakord ndryshe, prokurimi i mallrave, punimeve dhe shërbimeve për Projektin, të cilat do të financohen nga arkëtimet e huasë, do të qeverisen nga dispozitat e mëposhtme:

a) Mallrat, punimet dhe shërbimet (përveç shërbimeve të konsulentëve të Projektit të cilët janë tashmë të angazhuar nga Huamarrësi në përputhje me procedurat e përcaktuara në kapitullin 5 të rregullores së prokurimit të BERZH-it).

b) Në funksion të pikës (a) më lart, procedurat e tenderit të hapur janë shpallur në kapitullin 3 të rregullores së prokurimit të BERZH-it.

c) Të gjitha kontratat do të jenë subjekt i procedurave të rishikimit që shpallen në shtojcën 1 të rregullores së prokurimit të BERZH-it.

d) Kontratat e tipeve të mëposhtme do të jenë subjekt rishikimi paraprak:

i) kontratat për mallra, punime dhe shërbime (duke përjashtuar shërbimet e konsulentëve të Projektit, të cilat trajtohen në pikën (ii) në vijim), që parashikohen të kushtojnë me një vlerë të barabartë me njëqind mijë euro (100.000 euro) ose më shumë;

ii) kontratat për shërbimet e konsulentëve që parashikohen të kushtojnë me një vlerë të barabartë me njëqind mijë euro (100.000 euro) ose më shumë.

3.04. Klauzolat mjedisore

Pa kufizuar përgjithësinë e paragrafit 4.02 (a) (iii) dhe paragrafit 5.02(c) (iii) të termave dhe kushteve standarde, po qe se Banka nuk bie dakord ndryshe, Huamarrësi:

a) do të zbatojë Projektin në përputhje me rregulloret dhe standardet mjedisore, që janë në fuqi herë pas here në juridiksionin ku ndodhet projekti dhe me standardet ekzistuese mjedisore në Bashkimin Europian në këtë datë (ose në qoftë se standarde të tilla nuk ekzistojnë në Komunitetin Europian, sipas udhëzimeve të zbatueshme mjedisore të Bankës Botërore);

b) do të sigurojë që punimet zbutëse të mjedisit të cilat i identifikojnë konsulentët e Projektit, të zbatohen;

c) do të marrë të gjitha masat që, gjatë zbatimit të punimeve në lidhje me projektin, kantierët e

ndërtimit të administrohen në përputhje me praktikat e mira ndërkombëtare dhe:

i) të merren masa për të administruar trafikun dhe zvogëluar shqetësimin e publikut;

ii) të merren masa paraprake për të siguruar sigurinë e punonjësve dhe përdoruesve të rrugës;

iii) të zvogëlojë sa më shumë ndërhyrjen e zhurmës;

iv) publiku të jetë i informuar mirë rreth punimeve të propozuara.

3.05 Konsulentët

Në mënyrë që të ndihmohet në zbatimin e Projektit, po qe se nuk bihet dakord ndryshe me Bankën, Huamarrësi do të punësojë ose të bëjë të punësojë sipas kërkesave, dhe të shfrytëzojë konsulentë kualifikimi, përvoja dhe termat e referencës të të cilëve do të jenë të kënaqshme për Bankën, për të ndihmuar në zbatimin e pjesës B të Projektit.

3.06 Shpeshtësia e raporteve dhe paraqitja e kërkesave

a) Deri në përfundim të Projektit, Huamarrësi do t'i paraqesë Bankës raporte vjetore në lidhje me problemet e mjedisit që lidhen me Projektin, siç parashikohet në paragrafin 4.04 (a)(iii) të termave dhe kushteve standarde, të cilat përfshijnë probleme të shëndetit të punonjësve dhe sigurisë në punë, që lidhen me Projektin. Raporte të tilla do të paraqiten brenda 120 ditëve pas fundit të vitit për të cilin raportohet dhe do të përmbajë artikujt e mëposhtëm specifikë:

(i) çdo ndryshim në ligjet dhe rregullat ekologjike në lidhje me këtë;

(ii) çdo incident që ka të bëjë me mospërputhjen në ligje dhe rregulla në lidhje me këtë, duke përfshirë çdo veprim ligjor që ka të bëjë me Huamarrësin ose Projektin.

b) Raportet periodike të Projektit, të referuara në paragrafin 4.04 (a) (iv) të termave dhe kushteve standarde duhet të dorëzohen çdo katërmujor, brenda 30 ditëve pas përfundimit të periudhës, për të cilën raportohet, deri sa Projekti të ketë përfunduar. Të tilla raporte duhet të përfshijnë elementet specifikë, si më poshtë:

i) Informacionin e mëposhtëm të përgjithshëm:

1) progresin fizik të arritur në zbatimin e Projektit deri në datën e raportit dhe gjatë periudhës për të cilën raportohet;

2) progresin në zbatimin e punimeve zbutëse të mjedisit sipas paragrafit 3.04 (b) më lart;

3) vështirësitë ose vonesat aktuale të pritshme në zbatimin e Projektit dhe ndikimi i tyre mbi planin e zbatimit, dhe hapat aktualë që janë marrë ose që planifikohet të ndërmerren, për të kapërcyer vështirësitë dhe shmangur vonesat;

4) ndryshimet e pritshme në datën e përfundimit të Projektit;

5) ndryshimet e specialistëve kryesorë në radhët e personelit të PIU-t, konsulentëve ose kontraktorëve;

6) çështjet që mund të ndikojnë në koston e Projektit;

7) informacion rreth çdo zhvillimi ose aktiviteti që ka të ngjarë të ndikojë mbi rentabilitetin ekonomik të cilësdo pjese të Projektit.

ii) Një grafik me shtylla, i cili do të mbështetet në planin e zbatimit të Projektit për të cilin Banka dhe Huamarrësi do të bien dakord në fillim të ose para zbatimit të kontratave të punimeve civile për pjesën A të Projektit, i cili do të tregojë progresin për secilën pjesë të Projektit, dhe duke përfshirë një grafik për shpenzimet aktuale e të planifikuara.

iii) Deklaratat financiare të cilat tregojnë hollësira të shpenzimeve të kryera nën secilën pjesë të Projektit dhe tërheqjet nga huaja, bashkë me një deklaratë e cila tregon:

1) përllogaritjet origjinale të kostove;

2) përllogaritjet e rishikuara të kostove, në qoftë se ka dhe arsyet për ndryshimet;

3) shpenzimet origjinale të kryera deri më sot;

4) arsyet për ndryshimet (sipas pikës 3 më lart) nga shpenzimet aktuale;

5) shpenzimet e përllogaritura për tre-mujorët e mbetur të vitit.

iv) Një deklaratë të shkurtër të gjendjes së përputhshmërisë me cilëndo prej klauzolave të Marrëveshjes së Huasë.

c) Deri sa Projekti të përfundojë, Huamarrësi do t'i paraqesë Bankës kopje të të gjitha raporteve të paraqitura tek IDA sipas marrëveshjes së kredisë së IDA-s dhe kopje të të gjitha raporteve

që u janë siguruar FMN-së ose IDA-s në lidhje me Projektin e Korridorit Lindje – Perëndim.

d) Menjëherë pas ndodhjes së ndonjë incidenti ose aksidenti që lidhet me Projektin, të cilët mund të kenë ndikim materialisht negativ mbi mjedisin, shëndetin ose sigurinë, Huamarrësi do të njoftojë Bankën me faks ose teleks, duke specifikuar natyrën e një incidenti ose aksidenti të tillë dhe hapat që Huamarrësi po merr për të ndrequr sa më lart. Pa kufizuar përgjithshmërinë e sa më lart, një incident ose aksident mund të ketë ndikim materialisht negativ mbi mjedisin, shëndetin ose sigurinë, në qoftë se ndonjë ligj që është në fuqi kërkon njoftimin e një incidenti ose aksidenti të tillë para një autoriteti qeveritar. Një incident ose aksident i tillë i cili shoqërohet me humbje jetësh ose plagosje serioze të shumëfishta, mjekimi i të cilave kërkon shtrimin në spital, ose një incident ose aksident i tillë bëhet i njohur publikisht nëpërmjet medias dhe mjeteve të tjera.

Neni 4
Klauzolat financiare

4.01 Regjistrat dhe raportet financiare

a) Huamarrësi do të mbajë, lidhur me departamentet ose agjencitë e tij, që janë përgjegjëse për zbatimin e Projektit ose të ndonjë pjese të tij, procedura, regjistra e llogari për të pasqyruar, në përputhje me standardet e kontabilitetit të pranuara botërisht e të zbatuara rigorozisht, operacionet, burimet dhe shpenzimet që lidhen me Projektin, si dhe për të monitoruar dhe regjistruar ecurinë e Projektit (duke përfshirë kostot e tij dhe përfitimet që rrjedhin prej tij).

b) Huamarrësi:

i) do të këtë regjistrat dhe llogaritë, të cilat përmenden në pikën (a) të këtij paragrafi për çdo vit fiskal të revizionuar, në përputhje me parimet e revizionimit të pranuara botërisht e të zbatuara rigorozisht nga kontrollues të pavarur dhe të pranueshëm për Bankën;

ii) do të sigurojë për Bankën, sa më shpejt të jetë e mundur, por në çdo rast jo më vonë se katër muaj pas fundit të çdo viti fiskal, raportin e një revizionimi të tillë, nga kontrollorët e pavarur dhe me hollësirat që Banka i ka kërkuar me të drejtë;

iii) do të sigurojë për Bankën informacione të tilla lidhur me regjistrat dhe llogaritë, si dhe me revizionimin, siç mund t'i kërkojë ajo me të drejtë herë pas here.

Neni 5
Pezullimi

5.01 Pezullimi

Dispozitat në vijim janë specifikuar në funksion të paragrafit 7.01(a)(xiv) të termave dhe kushteve standarde:

a) Kuadri legjislativ e rregullator i zbatueshëm ndaj Projektit në territorin e Huamarrësit, ndryshohet, pezullohet, zhvleftësohet, anulohet ose pushon së qenuri në fuqi.

b) E drejta e Huamarrësit për të tërhequr fonde nga fondet e NEQ-it ose fondet e bashkëpunimit italian, pezullohet, anulohet ose mbyllet tërësisht ose pjesërisht sipas kushteve të marrëveshjeve përkatëse, me kusht që dispozitat e këtij paragrafi nuk do të zbatohen, në qoftë se Huamarrësi provon sipas kërkesës së Bankës që grantet ose hua koncensionare të mjaftueshme për të siguruar fondet e duhura për Projektin, janë të disponueshme për Huamarrësin nga burime të tjera me afate dhe kushte që janë në përputhje me detyrimet e Huamarrësit nën këtë Marrëveshje.

c) E drejta e tokës, që është e nevojshme për të zbatuar pjesën A të Projektit, nuk është marrë nga Huamarrësi për çdo lloj arsyeje dhe nuk është vënë në dispozicion kontraktorëve nën kontratë, siç përshkruhet në paragrafin 6.01(b) në ose përpara 17 qershorit 2003.

Neni 6
Efektiviteti

6.01 Kushtet përpara efektshmërisë

Dispozitat në vijim janë specifikuar në funksion të paragrafit 9.02 (c) të termave dhe kushteve standarde si kushte shtesë për efektshmërinë e kësaj Marrëveshjeje.

a) Huaja origjinale anulohet.

b) Bankës i sigurohen prova, në formë e përmbajtje të kënaqshme për ratifikimin e kësaj kontrate nga ana e Parlamentit.

c) Bankës i sigurohen prova, në formë e përmbajtje të kënaqshme për të, që Huamarrësi ka hyrë në kontrata për punimet civile të përfshira në pjesën A të Projektit.

d) Bankës i sigurohen prova, në formë e përmbajtje të kënaqshme për të, që të gjithë të drejtat e tokës së nevojshme për zbatimin e pjesës A të Projektit janë siguruar nga Huamarrësi dhe janë vënë në dispozicion të kontraktorëve nën kontratat e përshkruara në pikën (c) më lart.

e) Bankës i sigurohen prova, në formë e përmbajtje të kënaqshme për të, që e drejta e Huamarrësit për të tërhequr fonde nga fondet e NEQ-it është aktivizuar.

f) Bankës i sigurohen prova, në formë e përmbajtje të kënaqshme për të, që e drejta e Huamarrësit për të tërhequr fonde nga fondet e bashkëpunimit italian është aktivizuar.

g) Bankës i sigurohen prova në formë e përmbajtje të kënaqshme për të, që Huamarrësi ka vënë në dispozicion të Projektit dy milion euro (2.000.000 euro) nga fondet e veta.

6.02 Opinioni ligjor

Në funksion të paragrafit 9.03 të termave dhe kushteve standarde, opinione dhe këshilla ligjore do të jepen në emër të Huamarrësit nga Ministria e Drejtësisë.

6.03 Kushtet e livrimit të huasë

Çdo tërheqje nga huaja do të jetë subjekt ndaj kushtit që kjo Marrëveshje është deklaruar efektive nga Banka.

6.04 Përfundimi për mosaktivizim të Marrëveshjes

Është përcaktuar data një vit pas datës së kësaj Marrëveshjeje, në funksion të paragrafit 9.04 të termave dhe kushteve standarde.

Neni 7
Të ndryshme

7.01 Njoftimet

Adresat në vijim janë përcaktuar në funksion të paragrafit 10.01 të termave dhe kushteve standarde:

Për Huamarrësin:
Ministria e Financave
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", 1
Tiranë
Shqipëri
Në vëmendje të: Ministrit të Financave
Faks: 355 4 228 494

Për Bankën:
Banka Europiane për Rindërtim e Zhvillim
One Exchange Square
London EC2A 2JN
United Kingdom
Në vëmendje të: Njësisë së Administrimit të Operacioneve

Faks: 0044 20 7338 6100
Teleks:8812161
Kthim përgjigje:EBRD L G

Në dëshmi të tyre palët, të cilat veprojnë nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar, kanë nënshkruar këtë marrëveshje në tri kopje dhe e kanë dërguar në Tiranë, Shqipëri në datën e shkruajtur më lart.

Republika e Shqipërisë.

Nga: _____
Emri: Kastriot Islami
Titulli: Ministër i Financave

Banka Europiane për Rindërtim e Zhvillim

Nga: _____
Emri: Riccardo Puliti
Titulli: Bankieri i Parë dhe Drejtor i

Autorizuar, Grupi i Transportit

Plani 1 – Përshkrimi i Projektit

1. Qëllimi i Projektit është: (i) të ndihmojë Huamarrësin në zbatimin e një programi riparimesh, rehabilitimesh dhe përmirësimesh të sigurisë përgjatë 30.5 kilometrash rrugë në Korridorin Lindje-Perëndim, ndërmjet Elbasanit dhe Librazhdit; (ii) të reduktojë koston e punës së automjeteve nëpërmjet parandalimit të përkeqësimit që shkaktohet nga cilësia e dobët e sipërfaqes së rrugës; (iii) të reduktojë numrin e aksidenteve rrugore dhe plagosjet serioze nëpërmjet përmirësimit të cilësisë; (iv) të zhvillojë konkurrencën për kontratat e punimeve rrugore nëpërmjet zhvillimit të një tenderi të hapur; (v) të rinovojë infrastrukturën e transportit nëpërmjet përfundimit të një sektori kyç të Korridorit Lindje –Perëndim, i cili lidh territorin e Huamarrësit me ish -Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Greqinë (Korridori i VIII BE-së).

2. Projekti konsiston në pjesët e mëposhtme, të cilat janë objekt modifikimi sipas marrëveshjeve që Banka dhe Huamarrësi mund të arrijnë herë pas here.

Pjesa A: Punimet e ndërtimit

A-1 Rinovimi i segmentit afërsisht 22.5 km të gjatë të rrugës Elbasan –Librazhd në një rrugë 7.5 metra e gjerë me 5 cm veshje asfalt–beton dhe me shpatulla zhavorri 1.5 metra të gjera.

A-2 Rinovimi i segmentit afërsisht 8.0 km të gjatë të rrugës Elbasan–Librazhd në një rrugë 7.5 metra e gjerë me 5 cm veshje asfalt-beton dhe me shpatulla zhavorri 1.5 metra të gjera.

Pjesa B: Mbikëqyrja e punimeve të ndërtimit të pjesës A të Projektit

3. Projekti parashikohet të përfundojë në shkurt 2005.

Plani 2: Kategoritë dhe tërheqjet

1. Tabela bashkëngjitur këtij plani përcakton kategoritë dhe artikujt që do të financohen nga arkëtimet e huasë, shpërndarjen e shumave të huasë për secilën kategori dhe përqindjen e shpenzimeve për artikujt që do të financohen në këtë mënyrë në secilën kategori.

2. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1 më lart, për shpenzimet e mëposhtme nuk do të bëhen zbritje:

a) pagesat e bëra për shpenzime para datës së Marrëveshjes së Huasë;

b) shpenzimet nën kategorinë 1 deri sa Banka të miratojë kontratën për punimet civile të shpallura në pjesën A të Projektit.

Shtojca e planit 2

Kategoria	Shuma e huasë në monedhën e huasë	Përqindja e shpenzimeve për t'u financuar
1) Punimet e ndërtimit për pjesën A.	14.830.000 euro	66.0% e vlerës së kontratës, subjekt ndaj paragrafit 6.01 (b) të termave dhe kushteve të përgjithshme
2) Mbikëqyrja e punimeve të ndërtimit nën pjesën A	1.000.000 euro	100% e vlerës së kontratës së konsulencës
3) Kosto e shpështjellimit lidhur me anulimin e huasë origjinale	1.000.000 euro	100% e kostove të shpështjellimit
4) Komisioni i huasë	170.000 euro	100% e komisionit të huasë
Total	17.000.000 euro	